


Plaku Sofroni



PËR SHPIRTIN DHE JETËN

" 58.

Nuk ka asgjë më të dhimbshme se ajo dikush të ketë dashurinë e Krishtit në këtë botë. Ajo është luftë me përmasa kozmike.

" 59.

Si të shkojmë drejt Zotit? Kur synojmë drejt këtij qëllimi të vetëm gjithëka tjetër behet burrim i vuajtjes dhe dhimbjes. Megjithatë e mbartim këtë kryq duke u lutur.

" 60.

Ja paradoksi i jetës kristinane: duke i perzgjedhur vuajtjet e Krishtit për shpëtim të botës, ne jemi më afër Tij dhe jetës së përjetëshme.

" 61.

Kur do të vendosim ta ndjekim Krishtin çdo ditë e jetës sonë, bëhet ditë e vuajtjeve, e lotëve dhe e dhimbjes. Ndonjëherë lind pyetja: O Zot pse na krijove kështë, pa duhet të kalojmë nëpër kaq vuajtje? Jemi të pafuqishëm të kuptojmë se kjo përvojë e hidhur është rruga e shpëtimit.

" 62.

Ekzistenca e tokës për njeriun është dhembje e pafundme. Pse e durojmë të gjithë këtë? Sepse krijuesi erdhi dhe u vendos midis nesh. Dhe tani e njohim personalisht.

" 63.

Jemi të krijuar sipas modelit dhe sipas ngjashmërisë së Zotit. Kur e krahasojmë realitetin e jetës sonë të përditshme me këtë zbulim të Zotit, bëhemi të pashpresë. Përsë është kaq e vështirë të veprojmë këtu dhe tani si të krishterë? Për ne, të cilët dolëm prej asgjëje, çfarë lidhjeje ka midis parëndësisë sonë, kufizimit tonë dhe këtij qëllimi kaq të pafundem dhe të lartë?

" 64.

Trimëria për shpëtimin herë mund të jetë e lehtë dhe e njohur, ndërsa herë mund të jetë shumë e ngatëruar dhe mbi çdo fuqi njerëzore.

" 65.

Sigurisht më mirë është të mos bëjmë mëkate. Por, kur pendimi është i zjarrshëm, ai mund të kompensojë çfarë do humbje.

" 66.

Jemi të detyruar ta rruajmë shpirtin e pendimit gjate gjithë jetës sonë, deri në fund. Pendimi është baza e çdo jete askete shpirtërore. Ndjenja, parandjenja për mëkatin mund të mprehet aq shumë tek ne, kështu që të lindë me të vërtetë pendim i thellë.

" 67.

Mund të qajmë me orë, javë, vite me rradhë, derisa qenia jonë nuk rilind tërësisht prej Fjalës së Krishtit, prej porosive të Tij dhe para së gjithash prej bekimit të Shpirtit të Shenjtë. Kjo metamorfozë e qenies sonë, pas rënies së Adamit, kërkon shumë përpjekje dhe shumë kohë.

plaku Sofroni

" 68.

Pendimi nuk ka fund këtu në tokë, sepse fundi i bendimit do të thoshte se u bëmë të ngjashëm me Krishtin. Dhe ndryshimi më i vogël midis Krishtit dhe nesh, kërkon pendim të thellë: *Zoti Jezu Krisht Bir i Perëndise mëshirona*. Kjo fjalë e tregon largësinë që e ndiejmë midis Atij të përkryerit dhe Qenies së përjetshme dhe midis nesh. Në qoftë se me të vërtetë nuk jemi në gjithçka të ngjashëm me Zotin, si mund të jemi përjetësisht me të, pyet Shën Silluani Bekim i Ri. Për të, si dhe për ne, ajo është e pamundshme. Nuk na ngelet asgjë tjetër veçse durim.

" 69.

Njerëzit, vetë, nuk mund ta kuptojnë a bëjnë mëkat apo jo. Vetëm Zoti dhe Shpirti i Shenjtë ua zbulojnë atë. Në parajsë, kur Jezu Krishti fliste me Adamin, ai kundërshtoi ta akuzojë vetveten; *T'i ma dhe këtë grua dhe ajo më dha të ha prej këtij fryti*. Të mundohemi që të mos e fajësojmë Zotin!

" 70.

Në punët e vogla, në procedurat e lehta të mundohemi ta mbajmë qëndrimin e brendshëm të mëposhtëm: e mohoj vullnetin e frytit tim *të rëzuar*; dua në venat e mia të rrjedhë jeta e Zotit Vetë!

" 71.

Meqënëse Zoti ekziston, pranoj se të gjitha mëkatet dalin prej meje dhe jo prej Tij. Në qoftë se pranoj një qëndrim të tillë, Zoti do të më japë shpirt për pendim.

" 72.

Kur e shikojmë Krishtin *ashtu siç Është*, fillojmë të shihemi vetë, të vetëdijësohemi sa mëkatarë të mëdhej dhe të mjerë jemi dhe të qajmë në vetvete. Dashuria për të gjithë botën lind sipas masave të qarrjes sonë. Ndalojnë ndarjet! Të gjithë jemi një tek Krishti!

" 73.

Vetëm kur do të na ndriçojë drita e Krishtit mund t'i shikojmë mëkatet tona. Nëpërmjet lutjeve zemra jonë fillon dalngadalë t'i përfshijë veprimet e shpirtave që e mbushin botën. Në vend që të përparojmë, i shikojmë gjithnjë e më shumë qartësi pasionet që na rrëmbejnë. Në mënyrë paradoksale, kjo ndjenjë e *mospërparimit* është përparim. Edhe pse akoma nuk e kemi parë Dritën e pakrijueshme të Zotit, nëpërmjet saj i shikojmë mëkatet tona.

" 74.

Nuk mund të arrijmë lutje të pastër, përveç se nëpërmjet pendimit! Kur pendohemi, domethënë, kur pastrohemi prej çdo pasioni mëkatar, dalngadalë bëhemi të aftë të hyjmë ne Dritën Hyjnore.

" 75.

Rruga drejt njohjes së Zotit së pari kalon nëpër besim, nëpër dashuri dhe nëpër pendim.

" 76.

Jau dhëntë të gjithëve Zoti shpirtin e pendimit! Qani për mëkatet tuaja, qani që të mos *thahet* zemra juaj.

PËR SHPIRTIN DHE JETËN

" 77.

Puna kryesore është gjithmonë ta kemi parasysh mos përsosmërinë tonë para Zotit. Atëherë hyjmë në tendosje të përhershme midis vetëqortimit dhe dashurisë së Krishtit, midis pendimit dhe shpërndarjes në mëshirën e Zotit. Në njërin anë jetojmë në vuajtje, sepse jemi kaq larg Zotit, të Cilin E duam. Nga ana tjetër prapë, kjo vuajtje dhe kjo dashuri veprojnë si një zjarr i brendshëm dhe fuqishëm na afrojnë drejt Zotit. Kjo *tendosje* e gjeti shprehjen e saj të mprehtë në Fjalën e Krishtit tek Plaku Silluan: *Mbaje mendjen tënde në skëterrë dhe mos u dëshpero!* Kjo fjalë mund të shkaktojë frikë, llahtari dhe lemeri, por nuk duhet të na thyjë. Ajo është parimi bazë i jetës sonë tek Krishti.

" 78.

Si mund të jemi përherë në zjarrin e ferrit dhe të pasioneve, ndërsa në të njëjtën kohë prej Shpirtit të Shenjtë të marrim dëshmi për shpëtimin tonë. Për këtë na ilumizon gjendja e brendshme e Krishtit në Golgotë. Së pari i thotë hajdutit: *Sot do të jesh me Mua në parajsë.* Më vonë thotë: *Përse më latë?* Këto dy momente nuk bëjnë gjë tjetër veçse një moment. Në lloj të mënyrave të ndryshme, kjo gjendje e Krishtit në Golgotë është gjithmenë prezente tek njeriu dhe e shndërron përmbajtjen e jetës së tij. Të gëzohemi me të gëzuarit dhe të qajmë me të pikëlluarit, - thotë Apostull Pavli. Për ne këto fjalë janë të pakuptueshme.

" 79.

Nuk duhet të pohojmë se e pësërisim përvojën e Shën Silluanit, Shën Isak Sirinit, Shën Simeoni Bekim I Ri, Shën Grigorij Palama ose Shën Serafimi Sarovski. Në jetën shpirtërore nuk ekziston pësëritje e njëjtë, identikë, por thjeshtë, njëjtësi e Shpirtit në masë në të cilën përmbushet fjala: *Mbaje mendjen tënde në skëterrë dhe mos u dëshpero!*

" 80.

Asnjëherë nuk duhet ta krahasosh vetveten me asnjë person! Secili prej nesh, sado i vogël qoftë është i madh para Të përjetshmit! Perëndia me çdo qenie njerëzore vedos lidhje të përzemërt dhe të vetme.

" 81.

Për çfarë shkakut pasojat e mosbindjes së Adamit janë kaq shkatëruese? Pse jeta shpirtërore tek Krishti, në këtë botë merr formë tragjike të lufës ballë për ballë me vdekjen? Pse krijimi i Perëndisë është i lidhur me këtë mohim, vdekja, me këtë lufë plot me dhembje? Përse gjithçka që është krijuar nuk udhëheq në mënyrë harmonike drejt përsosmërisë së qenies njerëzore si model i Perëndisë? Pse jam i detyruar të luftoj kundër gjërave që më vrasin, pa pasur fuqi për atë. Nuk kuptoj! Në masën sipas së cilës Krishti dhe Shpirti i shenjtë janë zgjidhje për të gjitha problemet që i tejkalojnë forcat e mia, jetoj në mosdije apo njohuri për shume gjëra. Krishti është themeli i jetës sime! Mënyra në të cilën vepron më tërheq. Nuk e kuptoj atë që tha, por e thënë për mua është e mjaftueshme. Do të kuptoj kur të largohem nga kjo botë në botën tjetër.

" 82.

Përse Gestimania dhe Golgota janë të domosdoshme për botën? Përplasja e Krishtit me botën është plotësisht e pakuptueshme!

na albanski **Jordana Shemko**